

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr 2619/5 prot

Durrës, më 11 / 11 / 2025

V E N D I M

Nr 88 , datë 11. 11. 2025

**"PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QERA TË AMBIENTEVE PËR VENDOSJEN
E ATM-ve TË BANKËS CREDINS NË GODINËN CURRILA DHE KAMPUSIN
UNIVERSITAR TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR MOISIU"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", shkresës nr.2500 prot., datë 31.10.2025 "Kërkesë për dhënie me qera" të Administratorit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies me qera të një ambienti me sipërfaqe 4 m², godina nr.1 të kampusit universitar të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës për vendosjen e ATM Banka Credins.
2. Miratimin e dhënies me qera të një ambienti me sipërfaqe 4 m², godina Currila të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës për vendosjen e ATM Banka Credins.
3. Vlera e qerasë mujore (përfshirë dhe konsumin e energjisë) do të jetë 11680 lekë në muaj për çdo ATM.
4. Shpërndarja e të ardhurave, për secilën nga objektet do të arkëtohen në llogarinë e të ardhurave të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës sipas faturës të lëshuar nga Institucioni.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtoria e Administrimit Financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada **ALIAJ**

